



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 2435 prot.
5

Tiranë, më 30.06 2021

URDHËR

Nr. 270, datë 30.06.2021

2 PËR

**NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 351, DATË 29.05.2020 PËR
“MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA DHE KUFIZIMEVE PËR PARANDALIMIN
E PËRHAPJES SË COVID-19” TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019, nenit 113 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si edhe Vendimit të Komitetit Teknik nr. 2435 datë 27.05.2021,



URDHËROJ:

Në Urdhrin nr. 351, datë 29.05.2020 Për “Marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid-19” të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë vijon:

1. Në pikën 3, gërma (b) shfuqizohet.
2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me përmbajtje si vijon:

“2/1. Aktivitetet kulturore dhe teatrot të zhvillohen me kapacitet të reduktuar deri në 30% të spektatorëve apo pjesëmarrësve, në përputhje me protokollet e miratuara për parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19 nga Instituti i Shëndetit Publik.”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, i fillon efektet më datë 01.07.2021 dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.



Ogerta Manastirliu
TIRANË